



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)  
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE, DHE PRANIM  
NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE.**

Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe të Kreut II, dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.3.2015 "Për Pranimin, Lëvizjen Paralele, Periudhën e Provës dhe Emërimin në Kategorinë Ekzekutive", i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall Procedurat e Lëvizjes Paralele dhe Pranimit në Shërbimin Civil, në pozicionin:

**1 (një) "Specialist i Prokurimeve" në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, Kategoria VI - 1.**

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË  
SHËRBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

- **Afati për aplikim për lëvizje paralele është data: 07. 03. 2026**
- **Afati për aplikim për pranim në shërbimin civil është data: 12. 03. 2026**

**Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin "Specialist" i Prokurimeve në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve (Kategoria IV - 1):**

- Përgatit regjistrin e parashikimit të prokurimeve, konform buxhetit të miratuar për

- investime dhe për shpenzime;
- Harton dokumentacionin përkatës për procedurat e prokurimit dhe shpalljen e tyre në APP;
  - Përditëson të dhënat në sistemin elektronik për procedurat e prokurimit dhe përgatitjen e procedurës, për KVO-në;
  - Administrimin elektronik, në mënyrë periodike të procesit të prokurimit, nga shpallja e procedurës deri në arshivimin e saj;
  - Hedh on-line të gjithë materialet e procedurës së prokurimit;
  - Mban marrdhënien periodike, ditore-javore me Agjencinë e Prokurimit Publik;
  - Njofton në mënyre elektronike dhe shkresore, Agjencinë e Prokurimit Publik për fazën e publikimit, njoftimit fituesit, lidhjes kontratës dhe anulimeve përkatëse, sipas afateve të përcaktuara në ligj për secilën procedure;
  - Harton kontratat dhe njofton subjektin për nënshkrimin e saj;
  - Harton dhe menaxhon Regjistrin e Procesit të Prokurimit i cili mbahet në protokollin e institucionit;
  - Asiston në mbledhjet e KVO-së dhe jep mendim si dhe bën interpretim ligjor për Dokumentat e tenderit, atëhere kur i kërkohet nga anëtarët e KVO-së;
  - Shqyrton, trajton dhe kthen përgjigje, të gjitha ankesave që kanë të bëjnë me Dokumentat e tenderit, përpara hapjes së procedurës dhe vë në dispozicion të gjithë materialin e nevojshem për trajtimin e ankesave;
  - Zbaton detyrat e ngarkuara sipas rregulloreve në fuqi dhe përshkrimit të vendit të punës si dhe planeve të punës të miratuara nga eprori përkatës;
  - Informon eprorin direkt mbi rezultatet e punëve në vazhdimësi dhe mbi vështirësitë e hasura në lidhje me to;
  - Punon për rritjen dhe kualifikimin e tij profesional në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, duke synuar sjelljen e risive në punën e tyre të përditshme;
  - Zbaton të gjitha detyrat e tjera të paplanifikuara dhe që mund të ngarkohen nga eprori, apo detyrat e dala nga bashkëpunimi ndërsektorial që nuk përfshihet në pikat me lart, që nuk përbëjnë shkelje ligjore, dhe që nuk çenojnë dinjitetin e punonjësit.

## **I-Lëvizja Paralele**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunës civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha Institucionet, pjesë e shërbimit civil.

### **1. Kushtet për Lëvizjen Paralele dhe kriteret e veçanta për pozicionin: “Specialist i Prokurimeve” në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve**

**Kandidati për Lëvizjen Paralele duhet të plotësojë kushtet si më poshtë vijon:**

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brënda së njëjtës kategori (Kategoria IV - 1)
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga Institucioni).
3. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit mirë ose shumë mirë.

## **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

1. Të zotërojnë Diplomë të nivelit Bachelor/ Master profesional, në Shkencat Juridike. Edhe Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat e marra në Universitetet jashtë vendit duhet të jenë të njehsuara nga Institucioni përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi).
2. Të kenë jo më pak se 1 (nje) vit eksperiencë pune në profesion. Preferohet të kenë eksperiencë pune të mëparshme në fushën e prokurimeve.
3. Të zotërojnë shumë mire gjuhën angleze ose një gjuhë të BE-së (të dokumentuar).
4. Të njohë programet bazë të kompjuterit.
5. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

## **2. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit, dokumentat si më poshtë vijojnë:

1. Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail;
2. Jetëshkrim të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të cilin e gjeni në link: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;
3. Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare;
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);
6. Vërtetim të Gjendjes Shëndetësore;
7. Vetëdeklarim të Gjendjes Gjyqësore;
8. Vlerësimin e fundit në punë sipas formatit të Ligjit në Shërbimin Civil;
9. Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.
10. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit brenda dates: 07. 03. 2026**

## **3. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak**

Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), listën e

kandidatëve që plotësojnë kushtet e Lëvizjes Paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e Lëvizjes Paralele të përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk do të publikohet por administrohet nga Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) e cila do të njoftojë në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës së e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, (Sektorit të Burimeve Njerëzore) brënda **3 (tre)** ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi merr përgjigje brënda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

**4. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista**  
Kandidatët që konkurojnë për pozicionin **“Specialist i Prokurimeve” në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve**, do të vlerësohen në lidhje me:

- *Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;*
- *Ligjin nr. 8454/1999, “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar;*
- *Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;*
- *VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;*
- *Udhëzimin nr. 04 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, i ndryshuar;*
- *Udhëzimin nr. 06 datë 16.07.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”;*
- *Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;*
- *Udhëzimin nr. 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin e tyre me mjete elektronike”;*
- *Udhëzimin nr. 06, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;*
- *VKM nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”, i ndryshuar;*
- *VKM nr. 291, datë 15.5.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”;*
- *VKM nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “operatori i blerjeve të përqendruara” sha, për kryerjen e*

*procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë”, i ndryshuar;*

- *Ligjin nr. 36/2020 për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë;*
- *VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë;*
- *Ligjin 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;*
- *Ligjin 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar;*
- *Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;*
- *Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat etike në administratën publike”.*
- *Akte ligjore dhe nënligjore për ndryshime të bazës ligjore të sipërcituar.*

## **5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

1. Dokumentacionin e dorëzuar, deri në 40 pikë.
2. Intervistën e strukturuar, deri në 60 pikë.

### **Vlerësimi i dokumentacionit:**

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, përvojën, trajnimet, kualifikimet e lidhurame fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

1. Njohuritë, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e punës, sipas fushës së njohurive;
2. Eksperiencat e tyre të mëparshme;
3. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) do të shpallë fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

### **III-Pranimi në Shërbimin Civil**

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpallje, në përfundim të Procedurës së Lëvizjes Paralele rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet Procedurës së Pranimi në Shërbimin Civil. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit.

#### **1. Kushtet dhe kriteret e veçanta për Pranim në Shërbimin Civil në pozicionin “Specialist” i Prokurimeve” në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve:**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të Shërbimit Civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të Ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

#### **Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil janë:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

#### **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

1. Të zotërojnë Diplomë të nivelit Bachelor/ Master profesional, në Shkencat Juridike. Edhe Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat e marra në Universitetet jashtë vendit duhet të jenë të njehsuara nga Institucioni përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi).
2. Të kenë jo më pak se 1 (një) vit përvojë pune në profesion. Preferohet të kenë eksperiencë pune të mëparshme në fushën e prokurimeve.
3. Të zotërojnë shumë mire gjuhën angleze ose një gjuhë të BE-së (të dokumentuar).
4. Të njohë programet bazë të kompjuterit.
5. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

#### **3. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit, dokumentat si më poshtë vijon:

1. Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail;
2. Jetëshkrim të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të cilin e gjeni në link: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;
3. Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare;
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);
6. Vërtetim të Gjendjes Shëndetësore;
7. Vetëdeklarim të Gjendjes Gjyqësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit brenda dates: 12. 03. 2026**

### **3. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak**

Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë, kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk do të publikohet por administrohet nga Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) e cila do të njoftojë në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës së e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, (Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) brenda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi merr përgjigje brenda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

### **4. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të vlerësohen kandidatët**

Kandidatët që konkurojnë për pozicionin e “Specialist” i Prokurimeve në Sektorin e Financës, do të vlerësohen në lidhje me:

1. *Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;*
2. *Ligjin nr. 8454/1999, “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar;*
3. *Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe akteve*

- nënligjore të dala në zbatim të tij;
4. VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
  5. Udhëzimin nr. 04 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, i ndryshuar;
  6. Udhëzimin nr. 06 datë 16.07.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”;
  7. Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;
  8. Udhëzimin nr. 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin e tyre me mjete elektronike”;
  9. Udhëzimin nr. 06, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;
  10. VKM nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”, i ndryshuar;
  11. VKM nr. 291, datë 15.5.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”;
  12. VKM nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “operatori i blerjeve të përqendruara” sha, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë”, i ndryshuar;
  13. Ligjin nr. 36/2020 për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë;
  14. VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë;
  15. Ligjin 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
  16. Ligjin 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar;
  17. Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
  18. Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat etike në administratën publike”.
  19. Akte ligjore dhe nënligjore për ndryshime të bazës ligjore të sipërcituar.

## **5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

1. Vlerësimi me shkrim sipas fushës së njohurive, deri në 60 pikë.
2. Intervista e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë.
3. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

## **6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) do të shpallë fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit. Të gjithë kandidatët pjesmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në adresën:

Avokati i Popullit, Bulevardi “Zhan’ Dark” nr.2, Tiranë